



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 24.02.2023, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s datë 16.02.2023 dhe datë 20.02.2023.
2. Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC, në Gjirin e Vlorës.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Kurum International” sh.a., për modifikimin e licencës nr. 213, Seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 06.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të bordit të komisionerëve të ERE-s tek shoqëria “Kurum Interntional” sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet.
4. Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE në lidhje me kërkesën e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kW.
5. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Natyre Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
6. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.